



THIRRJE PER APLIKIM

SKEMA E MBESHTETJES ME GRANTE

SHOQATA E BIZNESIT - TID KORCA

1. HYRJE (NJHUNI ME PROJEKTIN DHE SKEMËN E MBËSHTETJES ME GRANTE)

Program i Granteve ndaj Sipërmarrjeve i Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim do të mbështesë bizneset e zonës TID Korça nëpërmjet një skeme Grantesh. Qëllimi është përmirësimi i nivelit të bizneseve dhe klimës tregtare, rritja e qëndrueshmërisë financiare, rritja e larmishmërisë së produkteve dhe shërbimeve të ofruara si dhe zhvillimi tërësor i zonës TID.

2. PRANUESHMËRIA

Tre fushat sipas të cilave do të vlerësohet pranueshmëria e aplikimeve do të jenë:

- Llojet e bizneseve të cilët mund të aplikojnë për grant
- Tipet e projekteve (investimeve) dhe aktiviteteve të pranuar
- Buxhetet dhe ndarja e kostove

2.1. KUSH MUND TË APLIKOJË

Programi i mbështetjes me Grante do të marrë në konsideratë llojet e mëposhtme të bizneseve:

- a. Shërbime Hotelerie dhe restoranti
- b. Biznese me profil artizanati (tregti dhe shërbime)
- c. Tregti dhe shërbime të nënprodukteve ushqimore dhe produkteve të përpunuara ushqimore, me origjinë Shqipëtare (shembuj si trahana, pastërma, zahire etj)
- d. Agjensi dhe pika informacioni turistik
- e. Aktivitete shërbimi (përfshirë këtu zyra noterie, konsulencë financiare etj.)
- f. Aktivitete të tjera shërbimi (qendra estetike, parukeri, rrobaqepës etj.)
- g. Tregti dhe shërbime me tematike specifike për fëmijë
- h. Butik veshjesh;
- i. Biznese me tematike artistike, tregti dhe shërbime (galeri arti, antikuare, koleksionues etj)
- j. Farmaci dhe kozmetikë
- k. Argjendari

Të gjithë aplikimet duhet të përfaqësojnë investime të finalizuara pas datës së njoftimit të “**Thirrjes për Aplikim në Skemën e Granteve**”. Një përjashtim do të përbëjnë investimet madhore të cilat do të tejkalojnë vlerën prej \$ 100,000. Të tilla aplikime do të trajtohen veçanërisht dhe procesi i negociatave do të ndiqet drejtpërdrejtë nga AADF, përfshi ndjekjen e proçdurës së aprovuar, afatet përfundimtare të investimit dhe limitet e bashkë-financimit.



2.2. INVESTIMET QË MBËSHETETEN

Bashkëfinancimi mund të përdoret për secilin nga artikujt e listuar më poshtë:

- a. Blerje mobiljesh (të tilla si tavolina, karrige etj)
- b. Makineri dhe pajisje (të tilla si frigoriferë, vegla artizanati, ekspres etj)
- c. Materiale reklamuese të përhershme
- d. Pajisje ndriçimi të jashtme, dritare të jashtme, tabela orientuese
- e. Investime rikonstruksioni/restaurimi të ambjenteve të brëndshme/të jashtme
- f. Paguesa qiraje për bizneset e artizanatit dhe tematikave artistike (aktivitete të shprehura në pikat **2.1/b** dhe **2.1/i** më sipër) si dhe
- g. Të tjera (do të konsiderohen në varësi të rasteve)

2.3. LIMITET E BASHKËFINANCIMIT

Buxheti i angazhuar i granteve për këtë thirrje për aplikim është 100,000 \$. Në mënyrë që aplikuesi të fitojë të drejtën e përfitimit të grantit, nevojitet të vërtetojë përfshirjen e tij financiare në investimin për të cilin po kërkon bashkëfinancim. Përfituesit pritet të pëmbushin të gjitha angazhimet e marra lidhur me ndarjen e kostove.

Shumat potenciale të Bashkëfinancimeve, bazuar në diapazonet e investimeve për secilin aplikues, do të jenë sipas tabelës vijuese:

Diapazoni i Investimit	Shuma maksimale e përfituar	Shuma maksimale e tarifës në favor të shoqatës BID/TID	Shuma totale maksimale e financuar nga AADF
≤20,000 \$	\$3,000	\$600	\$3,600
20,001\$-30,000\$	\$5,000	\$1,000	\$6,000
30,001 \$ - 50,000 \$	\$10,000	\$2,000	\$12,000
50,001 \$ - 100,000 \$	\$20,000	\$4,000	\$24,000
> 100,000 \$	Termet dhe kushtet e granteve do të negocohen direkt nga AADF.		

Në rastet e rimbursimit të pagesave të qirave, rimbursimi nuk do të tejkalojë vlerën e \$ 10,000 gjatë një periudhe 2 – vjeçare. Paguesa e qirasë dhe rimbursimi nuk mund të tejkalojnë raportin 2:1, me fjalë të tjera mbështetja e AADF do të jetë maksimalisht në një nivel prej 50%. Rimbursimi mund të bëhet në fund të çdo semestri, bazuar në prova se qiramarrësi ka shlyer qiranë sipas kontratës së qirasë së paraqitur.

Për investime mbi nivelin \$ 30,000, do të kërkohet një projekt arkitekturor (në bazë të të cilit do të kryhet investimi).

Në çdo rast AADF ruan të drejtën e rishikimit të shumës maksimale të përfituar për aplikues individual, në rast të jashtëzakonshme, siç mund të jenë nevoja të veçanta të investimit në zonë, kërkesa shumë e lartë për bashkëfinancime apo numri shumë i lartë i përfituesve.



3. SI MUND TË APLIKOHET

3.1 PROÇESI I APLIKIMIT

Materialet informuese lidhur me aplikimin për bashkëfinancim do të shpërndahen tek çdo person i interesuar. Gjithashtu çdo aplikant do të orientohet në mënyrën e duhur për të plotësuar dokumentacionin dhe formën e aplikimit sipas proçdurave të miratuara. Çdo dokumentacion financiar i paraqitur do të ruhet konfidencialisht.

a. Koha

Afati i fundit i aplikimeve për të përfituar Bashkëfinancimin do të jetë 15 Tetor 2018. Në raste të veçanta AADF ruan të drejtën për të marrë në konsideratë aplikime të paraqitura pas skadencës së afatit të lartpërmendur.

b. Kërkesat minimale

Fondacioni Shqiptaro – Amerikan për Zhvillim do të mbështesë investimet me një kontribut maksimal deri në masën 50%. Një shumë e barabartë me 20% të grantit do ti transferohet shoqatës TID Korça . Kjo shumë do të transferohet në mënyrë të pavarur dhe nuk do të prekë grantin e miratuar. Për aplikimet në të cilat do të nevojitet ekspertiza e palëve të treta (shembull raportet e vlerësimit të investimit nga inxhinierë të liçensuar), shpenzimet e lidhura me të tilla shërbime do të zbriten nga pjesa e 20% të grantit e cila i transferohet shoqatës TID Korça.

c. Para-aplikimet

Aplikantët kanë mundësinë e aplikimit përpara se sa investimi të jetë finalizuar. Në raste të tilla, AADF dhe shoqata e biznesit TID Korça mund të para-miratojnë grantin dhe ti vënë në dispozicion aplikuesit një kontratë para-miratimi e cila do të përmajjë limitet maksimale të bashkëfinancimit.

Dokumentacioni i paraqitur do të duhet të përfshijë paketën e plotë të aplikimit dhe vlerësimet financiare të investimit që planifikohet të kryhet. Vlerësime financiare të cilat duhet të jenë të mbështetura nga ofertat e marra nga investitori lidhur me çdo makineri/shërbim/artikull që do të jetë pjesë e investimit.

Disbursimi i grantit do të bëhet vetëm pasi kushtet e vendosura në Miratim do të plotësohen. Duke përfshirë këtu vërtetimin e realizimit të investimit/shpenzimeve sipas listës së përfshirë në aplikim.

3.2 VLERËSIMI

Të gjitha aplikimet do të vlerësohen në lidhje me plotësimin e dokumentacionit dhe përputhshmërinë në lidhje me tipologjinë e bizneseve që mbështeten dhe kostot e rimbursueshme, sipas pikave 2.1 dhe 2.2.

Aplikimet do të vlerësohen pas përfundimit të afatit të aplikimit, mbi bazën e:

1. Rritjes së aktivitetit të biznesit në zonë
2. Rritjes së flukseve turistike në zonë
3. Rritjes së vlerës së pronave në zonë



4. Rritjes së punësimit në zonë
5. Konkurrencës së ulët e tipologjisë së biznesit në zonë
6. Ofrimit të produkteve “Made in Albania”

3.3 HAPAT E APROVIMIT

Proçesi i disbursimit të Grantit do të ndjekë hapat e mëposhtëm:

1. Aplikuesi plotëson me informacioni e nevojshëm Formën e Aplikimit të Grantit
2. Aplikuesi duhet të paraqesë fatura të vlefshme, mandate të pagesave të kryera si dhe dokumentacionin e inventarit apo të shërbimit të marrë
3. Shoqata TID dhe aplikuesit do të firmosin një listë inventari lidhur me artikujt e investuar, dokumentacioni i cili do të jetë pjesë dosjes origjinale të TID Korçës.
4. Një vlerësim financiar do të përfshihet në formën e aplikimit.
5. Të gjitha aplikimet mblidhen nga TID Korça deri në datën e fundit të aplikimit (15 Tetor 2018)
6. Bordi i TID Korça miraton një listë të reduktuar të aplikimeve, referuar procesit të vlerësimit të përcaktuar në pikën 3.2 si dhe buxhetit të granteve (100,000 \$).
7. Lista e reduktuar dërgohet nga TID Korça për aprovim pranë AADF.
8. Në çdo rast AADF mund të zhvillojë inspektime dhe vlerësime të pavarura në ambjentet e biznesit në të cilin do të kryhet investimi. Të tilla inspektime mund të kryhen nga stafi i AADF ose nga pale të treta të kontraktuara.
9. Fondacioni Shqiptaro – Amerikan për Zhvillim pasi merr paketën e plotë të aplikimit, vlerëson rastin dhe merr një vendim përfundimtar për të miratuar apo refuzuar kërkesën.

Pikat 1, 2 dhe 3 nuk janë të aplikueshme në rastet e paraaplikimeve.

3.4 PIKAT E KONTAKTIT

Për më shumë informacion në lidhje me mundësitë për përfitim dhe procedurën mund të kontaktoni administratoren e shoqatës TID Korça, zj. Nertila Begaj, në adresën infotidkorca@gmail.com; ose në numrin e telefonit: 0694529990. Gjithashtu, mund të kontaktoni personin e kontaktit nga AADF, z. Marin Shtylla, në adresën e emailit: m.shtylla@aadf.org.